

Si të hapësh biznesin

Si të hapësh biznesin tend?

1. Rregjistrimi ligjor i biznesit tuaj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Për të plotësuar hapin e parë, Ju duhet të paraqiteni dhe të aplikoni për rregjistrim biznesi pranë Q.K.R Korce e cila ndodhet tek Qendra e Sherbimeve për Publikun pranë Bashkisë Korce duke u paraqitur me dokumentin e identifikimit.

2. Rregjistrimi fiskal i biznesit në Drejtorinë e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq. Pas rregjistrimit të biznesit tuaj në (Q.K.R) ju duhet të paraqiteni pranë Drejtorisë së të Ardhurave në Bashkinë Maliq me qëllim rregjistrimin për efekte fiskale me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Një kopje të numrit të identifikimit të subjektit (Nuis) lëshuar nga Q.K.R
- Një kopje të ekstraktit të marrë nga Q.K.R
- Një kopje të kartës së identitetit
- Dokumentat e pronësisë : Fotokopje e kontratës së qerasë së mjedisit nese jeni qeramarrës, bashkëngjitur planimetria e objektit dhe m² të saj
- Fotokopje e dokumentit të pronësisë në se jeni pronar i objektit së bashku me planimetrinë përkatëse.
- Në rastin e Shoqërive Tregtare të ashtuquajtura Biznes i madh
- Akti i themelimit të Shoqërisë
- Statuti i Shoqërisë

Mbas dorëzimit të dokumentacionit të sipërpermendur në Drejtorinë e të Ardhurave ju do të regjistrohëni në regjistrin elektronik të biznesit si dhe do të pajiseni me passwordin tuaj për të hyrë në "Taksat e Mia", ku do të informoheni për detyrimet tuaja në kohe reale.